

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 276119
 Datë/Datum. 03.06.19

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDI KOMUNAL I KLINËS

Për Aktivitetin e Prokurimit: 634-18-7116-2-2-1/634-18-099-221

Sa i përket tenderit për: **HARTIMI I PROJEKTEVE ZBATUESE PER RRUGE TROTUARE DHE URA**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

STUDIO HAPSIRA SHPK
 (Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

BREGU I DIELLIT – MATI 1
 (Adresa)

PRISHTINË
 (Vendi)

044-536-914
 (Numri Telefonit)

10000
 (Kodi postar)

/
 (Numri i Faks-it)

BESART HALIMI
 (Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
studiohapsira@gmail.com
 (Adresa elektronike)

06.03.2019
 (Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

/
 (Emri i avokatit)

/

(Adresa e plotë)

/

(Numri i Telefonit)

/

(Numri i faks-it)

/

(Adresa elektronike)

/

(Data e parashtrimit të ankesës)

/

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Më datën 24.09.2018 është publikuar njoftimi për kontratë.
- Afati i dorëzimit ofertave , data 08.10.2018 koha 14:00:00 vendi K.K Kline
- Hapja e ofertave po të njëjtën datë :12.04.2018 koha 14:00:00 ,zyra e prokurimit Kuvendi Komunal Kline
- Më datën 05.11.2018 përmes formularit B58 – është bërë njoftimi për dhënie të kontratës përmes e-prokurimit jemi shpërblyer me Kontratë
- Më datën 27.12.2018 përmes formularit B58 – është bërë njoftimi për dhënie të kontratës përmes e-prokurimit jemi shpërblyer me Kontratë
- Më datën 22.02.2019 përmes formularit B58 – është bërë njoftimi për dhënie të kontratës përmes e-prokurimit jemi shpërblyer me Kontratë
- Më datën 23.05.2019 –Vendimi i AK lidhur me anulimin e këtij aktiviteti prokurimit.
- Kriteri i dhënies Kontratës : Çmimi më i ultë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Procesi i hapjes nga AK të këtij tenderi është bërë në përputhje me LP , kemi marrë pjesë , hapja është bërë më datën 08.10.2018 në ora 14.00 , nuk kemi pasur vërejtje të mbarëvajtjes të këtij procesi

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Më datën **21.05.2019** kemi bërë kërkesë për ri-shqyrtim pranë AK –Kuvendi Komunal Klinë lidhur me eliminimin tonë nga ky tender për kundër kushteve dhe kriterëve të plotësuar në përputhje me Fletën e të dhënave në Dosjen e Tenderit në përputhje me NENI 27 (Dosja e Tenderit), NENI 51 (Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes) ; NENI 52 (Njoftimi i kriterëve për dhënien e Kontratës)

Përmes vendimit të datës : 23.05.2019 na është refuzuar kërkesa për ri-shqyrtim na është hudhurë poshtë.

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

5. Si dëshmi se autoriteti kontraktues është pajtuar me paragrafët 1. deri 4. të këtij neni, ZKA dhe ZKF do të përgatisin dhe nënshkruajnë një "Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve". Deklarata e tillë e Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve do të përmbajë informatat në vijim: (i) një deklaratë të nevojave me shkrim, e cila i përmbledh rezultatet e vlerësimit të nevojave që është bërë nga autoriteti kontraktues sipas paragrafit 1. të këtij neni, (ii) një deklaratë me shkrim që konfirmon disponueshmërinë e fondeve, që demonstroi se autoriteti kontraktues i ka përmbushur obligimet e tij sipas paragrafit 2. të këtij neni, (iii) nëse është e aplikueshme, atëherë duhet që gjithashtu të dorëzohet një deklaratë me shkrim që i parashtron bazat, që kërkohen nga paragrafi 3. të këtij neni, për pritjet e autoritetit kontraktues në lidhje me përvetësimet e ardhshme; dhe (iv) nëse është e aplikueshme, një deklaratë me shkrim që përshkruan masat që autoriteti kontraktues i ka marrë për t'u përputhur me paragrafin 4. të këtij neni. ZKA do të sigurojë që origjinali i nënshkruar

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkelja e NENE-ve të LPP :

NENI 7 : Barazia në trajtim / jo-diskriminimi.

NENI 9 : Përcaktimin e nevojave të cilat duhet përmbushur)

NENI 10 : Mjetet për promovimin e transparencë.

NENI 24 : Zyrtaret e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit.

NENI 27 : Dosja e tenderit.

NENI 28 : Llojet e specifikimeve teknike.

NENI 40 : Njoftimi i kontratës.

NENI 51 : Njoftimi i kriterëve të dhënies kontratës.

NENI 56 : Dizpozita e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien

e kontratave .

NENI 59 : Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

NENI 60 : Kriteret për dhënien e kontratës .

NENI 64 : Dëshmi Kërkesa.

NENI 67 : Provat shkresore .

NENI 69 : Aftësia teknike dhe /ose profesionale.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

SHKELJA 1 :

Autoriteti Kontraktues ka vepruar kundërshtim me Ligjet e prokurimit publik NENI 9 , Paragrafi 1,2,3,4,5 dhe 6 (Përcaktimin e nevojave të cilat duhet përmbushur) dhe ligjin mbi financat , ka zvilluar procedura të prokurimit dhe e njëta dy herë na ka shpërblyer me kontratë , pa i siguruar fondet publike , duke na shkaktuar shpenzime financiare ,minimu 4 herë kemi paguar sigurim vazhdimi validiteti të terenderi , maltretimi në OSHP kjo humbje e kohës dhe dëmet e shkaktuar financiare për ne është e pa pranueshme , ku kemi një vendim të OSHP që i plotësojmë të gjitha kërkesa e përshtatshmërisë profesionale dhe teknike në dosje tenderit.

SHKELJA 2 :

Autoriteti Kontraktuese ka përdorur kriteret të cila na kanë diskriminuar duke përdorur kriteret të pa specifikuar qartë ku në këtë rast e ka qit në lajthitje edhe panelin shqyrtues të prokurimit teknik.

Në këtë rast O.E ankues përmes mashtrimit ka arritur ta lajthit Panelin Shqyrtues duke i shfrytëzuar mos specifikimin e qartë të kriterëve të përshtatshmërisë profesionale e qëllimit të Autoriteti Kontraktues me qëllim të manipulimit të këtij tenderi.

Duke i ndrruar vendet në mes të kërkesës së përshtatshmërisë profesionale me dëshminë dokumentare.

Nëse analizohen mirë këto kriteret shifet qartë manipulimi i vendeve të inxhinierit të ndërtimtarisë kërkesës së përshtatshmërisë profesionale me dëshminë dokumentare. Ku në këtë rast Ing i diplomuar i konstruksioneve- është inxhinierë i diplomuar konstruksioneve të urave dhe i takon lamiës së Ndërtimtarisë sipas fushës së natyrës kontratës , e jo siq ka arritur ta bind pala ankuese Panelin shqyrtues të prokurimi Publik duke pretenduar se i takon inxhinierisë mekanike.

Kjo është absurde dhe pa pranueshme , pasi ne si kompani jemi eliminuar për një kriter e cila nuk është precizuar në FDT tek dëshmia dokumentare dhe kriteret profesionale.

Absurditeti më i madh është paraqitur në vendimin e OSHP me Nr 99/19 të datës 07.05.2019 paneli shqyrtues ku sqaron se Inxhinieri i Konstruksioneve i përket inxhinierit të makinerisë e jo të makinerisë , dhe ka dhënë sugjerime që të vërtetohet në adresën e fakultetit të inxhinierisë Mekanike drejtimi (Konstruksione dhe Mekanizëm).

Pas verifikimit të diplomës dhe planprogramit në fakultetin e inxhinierisë Mekanike drejtimi (Konstruksione dhe Mekanizëm) , kemi vërejtje që ky planprogram dhe diplomë ka të bëjë me industrinë e prodhimit automjeteve , mekanizmave për punë , ky planprogram dhe diplomë nuk ka të bëjë fare me natyrën e kontratës dhe aktivitetin e prokurimit duke e futur në lajthitje Panelin Shqyrtues Prokurimit Publik

Bazuar në argumentet me lartë , AK ka shkelur dispozitat e LPP bazuar në dispozitat ligjore të pretenduara më poshtë :

- ❖ Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit të kontratës . Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë , autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë , nëse është relevante dhe e nevojshme , njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në kriteret teknike dhe procedurave që shpallen drejtë dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet leferimi produkteve /shërbimeve , nga operatorët ekonomik mund të kërkojë që të dëshmojnë aftësin e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim , sipas llojit , sasisë dhe qellimit të produktit/shërbimeve që furnizohen
- ❖ Ne STUDIO HAPSIRA SHPK – Deklarojmë se kemi plotësuar , dërguar dhe dorëzuar të gjitha kërkesat dhe dëshmitë e dokumentuara të parashtruara nga ana e AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit në harmoni me LPP , dhe se të gjitha zarfet ,si origjinali dhe kopjet kanë qenë të mbyllura.
- ❖ Ne STUDIO HAPSIRA SHPK- Kemi ofertuar me çmimin konkurues dhe kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi me çmimin më të ultë.
Të gjitha Autoritet Kontraktues , janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike , njëkosisht duke marrë në konsiderat lëndën dhe qelimin e prokurimit.

Me këtë rast AK ka bërë devijim të vogël i cili bie ndeshë me Ligjin e Prokurimit Publik :

- NENI 27 (Dosja e Tenderit) , paragrafi 1 dhe 10
- NENI 51 (Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes) , paragrafi 1 , 2 dhe 3
- NENI 52 (Njoftimi i kriterëve për dhënien e Kontratës) , paragrafi 1 , 3 dhe 10
- ❖ Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatatë e kërkuara janë vendosur dhe përshkruar në këtë NEN, duhet të jenë drejtëpërdrejtë relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

- ❖ Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit , të gjitha Autoritet Kontraktuese do të sigurojnë (i) pjesëmarrjen me të gjërë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimi i rregullt, dërgimi dhe /ose disponueshmëria e gjitha njoftimeve, ftesave , informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj ; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve , kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik ; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie , duke përfshirë rëndësin relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë; (v) që asnjë kërkesë , specifikim që nuk është saktësuar kështu të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënie ; (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve ,kritereve dhe specifikimeve teknike.

Duke u bazuar në argumentet e specifikuar më lartë kërkojmë nga AK të bëjë anulimin për dhënie Kontratës , e njëjta ta kthejë lëndën në rivlerësim dhe të marrë si të bazuar kërkesën tonë për ri-shqyrtim të lëndës , pasi konsiderojmë që AK gjatë këtij aktiviteti të prokurimit në masë substanciale nuk e ka rrespektuar LPP

Në të kundërtën jemi të obliguar ta dërgojmë lëndën në Gjykatën Themelore në Prishtinë

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e supozuara kanë shkaktuar dëmtim të imazhit kompanisë , një numër i konsiderueshëm të punëtorve kanë mbetur pa punë , duke llogaritet shpenzimet , kamatatë , tarifën e avokatit deri sa të zgjidhen kontekstet.

Vlera e dëmit kap vlerën 25, 000.00€, të cilën Autoriteti Kontraktues është i obliguar të ja paguaj palës dëmtuar në rast se humb kontekstin Gjyqësorë

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes se mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*